

URDHËR
Nr. 172, datë 3.11.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të pikës V/2, shkronja “a”, të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen më shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar, si dhe shkresës nr. 8071, datë 16.10.2017, të Autoritetit Rrugor Shqiptar, “Kërkesë për pajisje me autorizim”,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Autoritetit Rrugor Shqiptar jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km, të lëshohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar, z. Afrim Qëndro.
 2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen më shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar.
 3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Damian Gjiknuri